



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1066/1 prot.

Tiranë, më 10.12.2021

VENDIM

Nr. 157, datë 10.12.2021

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 35, DATË 08.04.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 35, datë 08.04.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e pjesshëm të ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 356 prot., datë 26.02.2021, prej nëpunësit *****.”

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 356 prot., datë 26.2.2021, nëpunësi *****, ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij për shkak të ristrukturimit të institucionit, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Politikave të Decentralizimit”, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat, në Ministrinë e Brendshme, është i padrejtë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Ministrisë së Brendshme të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 35, datë 08.04.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e pjesëshëm të ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 356 prot., datë 26.2.2021, prej nëpunësit *****.”*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Departamenti i Administratës Publike ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.35, datë 08.04.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Departamenti i Administratës Publike, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse DAP, për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr.35, datë 08.04.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 2611/3 prot., datë 24.06.2021, *“Përcillen vendimet e Departamentit të Administratës Publike në zbatim të vendimeve nr. 35, datë 08.04.2021 dhe nr. 53, datë 17.05.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, dërguar Ministrisë së Brendshme dhe për dijeni Komisionerit, ka bashkëlidhur vendimin nr.22 prot., datë 24.06.2021, ka vendosur anulimin e pikës 78, të aktit nr. 1320/66, datë 19.02.21, *“Për transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të institucionit”*, dhe ka rikthyer për rishikim të pjesëshëm propozimin e Komisionit të Ristrukturimit.

Gjithashtu, me vendimin e Komisionit të Ristrukturimit me nr. 1831/3 prot., datë 05.10.21, është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunësit ***** nga pozicioni *“Specialist”* në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave, në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, kategoria e pagës III-b, në pozicionin *“Specialist”* në Sektorin e Shërbimeve në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme, kategoria e pagës III-b.

Vërej se, nga ana e njësisë Përgjegjëse DAP janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 35, datë 08.04.2021, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr.35, datë 08.04.21, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e pjesshëm të ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën. nr. 356 prot., datë 26.02.2021, prej nëpunësit *****.”*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.35, datë 08.04.2021.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha